



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) dhe dispozitave të nenit 41 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008), dhe nenit 36 paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2023, merr këtë

V E N D I M
P Ë R
ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KRYEQYTETIT

- I. **MIRATOHET** Vendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.
- II. Kryesues i Kuvendit, sipas pikës I të këtij vendimi, zgjidhet Pëllumb Bajcinovci, nga radhët e anëtarëve.
- III. Mandati i kryesuesit zgjat, deri në inaugurimin e Kuvendit të ardhshëm, në pajtim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet lokale, i cili është në fuqi.
- IV. Punët dhe detyrat e kryesuesit të Kuvendit janë të parapara me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimin administrativ nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, dhe Statutin e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/01-151871/23, më 24.07.2023

ANËTARI MË I VJETËR I KUVENDIT
AJET BRAJSHORI

